



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 8. 10.2013, në orën 10.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë anëtarët e Komisionit: Suzan Novoberdali – kryetare,
Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Albana Gashi,
Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Shiroka – Pula.

Stafi mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi – Zyrtar i lartë ligjor, Sulltane Gashi -
zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit-UNICEF.

Pjesëmarrësit e tjerë: Nuredin Ibishi -UNDP, Elita Vokshi-OSBE, Lejla Selimi-OSBE,
Florie Kryeziu UNICEF, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Sead Bardhi-ZPRK, Edona Peci-
BIRN, Albana Bajrami-RTK, Teuta Prekazi-UNMIK, Ron Gjinovci-QHDP, Flutura
Gashi-Rrokum dhe Dona Llukaj- Radio- Dukagjini,

Të ftuar: Nenad Rashiq Muhamet Gjocaj, Gani Halilaj, Prenk Gjetaj, Kushtrim Gara dhe
Arsim Agani.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 17 shtator 2013;
3. Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Personat e Zhdukur: i ftuar është kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur - z. Prenk Gjetaj;
4. Informata e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me gjendjen në Institutin Special në Shtime dhe informata e Ministrit të Shëndetësisë për gjendjen në Qendrën e Shëndetit Mendor në Shtime;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komisionit për sesionin vjeshtor 2013;
6. Shqyrtimi i peticioneve;
7. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe vazhdoi sipas rendit të ditës:

Takimi filloi me pikën 3 të rendit të ditës pasi që i ftuar ishte z. Prenk Gjetaj, kryetar i Komisionit Qeveritar për personat e zhdukur.

3. Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Personat e Zhdukur: I ftuar është kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur - z. Prenk Gjetaj

Kryetarja - I njoftoi të pranishmit se në takimet e kaluara Komisioni ka vendosur që ta monitorojë Ligjin për personat e Zhdukur. Në lidhje me këtë monitorim Grupi Punues ka përpiluar pyetësin i cili u është dërguar Komisionit Qeveritar dhe familjarëve të personave të zhdukur. Ajo po ashtu theksoi se lidhur me pyetësin kanë pasur një pakënaqësi nga Komisioni Qeveritar duke aluduar se pyetjet kanë konotacion politik. Për këtë qëllim Komisioni në takimin e kaluar ka debatuar dhe ka vendosur që të ftohet në Komision Kryetari i Komisionit Qeveritar dhe të debatohet lidhur me këtë çështje.

Prenk Gjetaj – Pasi i përshëndeti të pranishmit tha se pyetësit i kanë marrë nga Komisioni. Ai i njoftoi se vërejtjet janë të formulimi i pyetjeve, sepse kanë konsideruar se kanë konotacion politik. Komisioni Qeveritar ka pasur disa takime me Komisionin për të Drejtat e Njeriut duke bashkëpunuar për çështje të personave të zhdukur. Ai tha se duke marrë para sysh numrin e personave të zhdukur ekziston arsyeja që të funksionojë Komisioni Qeveritar dhe institucionet e organizatat e tjera lidhur me çështjen e personave të pagjetur. Edhe pse ka shumë përpjekje prapëseprapë mungojnë informacionet dhe dëshmitë të cilat ndikojnë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Ai përmendi mbështetjen e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, ndihma e të cilëve ka ndikuar në arritjen e rezultateve. Ai paraqiti një shqetësim lidhur me veprimin e Komisionit Ndërkombëtar i cili ka mbyllur Zyrën në Prishtinë që ishte pjesë e këtij Komisioni me qendër në Bosnje e Hercegovinë dhe ky veprim sjell pasoja, sepse ky Komision merret kryesisht me analiza të ADN – së, jo vetëm në Kosovë, por në tërë regjionin e ish – Jugosllavisë. Ai i njoftoi anëtarët e Komisioni se Komisioni Qeveritar aktivitetin e vet e drejton në koordinimin e aktiviteteve lidhur me personat e zhdukur dhe theksoi se është mirë që tani është baza ligjore për të cilën kanë pasur vërejtje vazhdimisht, sepse kanë qenë edhe zëdhënës të

kërkesave të familjarëve. Ai tha se kanë kërkuar edhe në fillim, sepse kanë qenë jo të kënaqur, mirëpo rrethanat të cilat kanë sjellë deri te aprovimi i ligjin janë të njohura. Ai theksoi se ky ligj ka mjaft mangësi, sepse nuk rregullon dhe nuk mbron të gjitha interesat e familjarëve të personave të zhdukur. Ai tha se kanë qenë të pakënaqur me disa çështje që kanë të bëjnë me anën sociale të cilat nuk janë të përfshira këtu, sepse kanë konsideruar që nuk është e nevojshëm që një çështje të përfshihet në dy ligje, sepse çështja e trajtimit social parashihet me një ligj të veçantë që është Ligji për kategoritë e luftës. Po ashtu u theksua se vërejtjet e familjarëve të personave të zhdukur janë të asaj natyre që ata diskriminohen në raport me kategoritë e tjera të luftës, si dhe nuk i gëzojnë benefitet të cilat duhet t' shfrytëzojnë. Lidhur me pyetësin ai tha se më mirë kishte qenë që të ulen së bashku në mënyrë që të gjendet një gjuhë e përbashkët. Pyetësi ka disa pyetje të cilat nuk duhej të ishin në atë mënyrë të formuluar. P. sh. duke qenë që veproni në Zyrën e Kryeministrit, Kryeministria dhe Qeveria ju ka ofruar përkrahje të mjaftueshme. Ai e theksoi se derisa Komisioni vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është dashur që dikush tjetër të pyetet se a përkrahet Komisioni mjaftueshëm nga Qeveria, sepse në momentin që nuk kanë përkrahje nga Qeveria ai tha se do të kishte dhënë dorëheqje.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur theksoi se pikërisht në titull duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për personat e zhdukur, sepse shumica e ligjit ekzistues rregullon kompetencat e Komisionit Qeveritar e shumë më pak rregullon çështje të tjera që lidhen me personat e zhdukur. Lidhur me pyetësin ajo tha se te pyetja e lartëtheksuar mendon se nuk ka asgjë kontestuese, por vetëm një përmbledhje e asaj se sa ka Komisioni mbështetje nga Qeveria. Ajo e përsëriti sërish pyetjen e saj se cilat pyetje sipas të ftuarve është kontestuese gjë që ka ndikuar në refuzimin e përgjigjeve në pyetësor.

Prenk Gjetaj – Theksoi se si obligim ligjor që kanë pasur ata kanë nxjerrë Rregulloren e Komisionit në bazë të të cilës funksionon ai Komision. Lidhur me mbështetjen nga Qeveria ai tha se ende nuk është nxjerrë një vendim për emërimin e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit. Gjithashtu në bazë të ligjit ai tha se obligohen që ta kenë një akt nënligjor lidhur me bazën e të dhënave dhe për këtë ai ishte i mendimit se kjo duhet të hartohet, sepse është e nevojshme që ta kenë bazën e të dhënave të tyre, e jo të bazohen në të dhëna nga institucionet e tjera.

Kryetarja – The se qëllimi i monitorimit është mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe këtu nuk ka konotacione politike lidhur me këto çështje. Gjendja duhet të paraqitet ashtu siç është, duhet të theksohet nëse ka mbështetje nga Qeveria dhe po ashtu duhet të theksohet në qoftë se kjo mbështetje mungon. Ajo ishte e mendimit që më mirë do të kishte qenë që të përgjigjen në çdo aspekt ku mendojnë se janë të përkrahur mjaftueshëm se sa të mos përgjigjen fare në pyetësor. Duke u ndërlidhur me pyetësin ajo pyeti se çfarë përkrahje konkretisht ata kanë nga Qeveria pasi që deklaruan se kanë përkrahje?

Prenk Gjetaj – Tha se në kuadër të kompetencave që ka Komisioni nuk ka probleme me mbështetje financiare. Asnjë aktivitet hulumtues, gërmues, vlerësues nuk mbetet në mungesë të mbështetjes financiare. Ai po ashtu tha se në vazhdimësi në kuadër të kompetencave të tyre mbështeten edhe shoqatat me projekte të veçanta të natyrës psiko-

sociale, si dhe trajnime të natyrës psiko-sociale. Ka pasur aktivitete të natyrës së ngjashme në shumë qytetet të Kosovës gjatë këtij viti. Aktivitete të tilla, por edhe aktivitete të tjera, që kanë karakter hulumtues, ose të ngjashëm në vazhdimësi mbështeten nga Qeveria.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke i përshëndetur të pranishmit theksoi se përveç pyetjeve që janë në pyetësor me rëndësi tjetër është edhe çështja se sa janë marrë para sysh rekomandimet e evropianëve për bisedimet Kosovë – Serbi. Duke marrë para sysh se ka qenë një delegacion me përfaqësues dhe nga Komisioni qeveritar dhe asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë informacion se çka ka ndodhur me ato bisedime. Ajo ishte e mendimit që Komisioni Qeveritar të bëjë trysni pozitive te Qeveria e Kosovës që në bisedimet Kosovë – Serbi që të jetë temë e bisedave çështja e personave të zhdukur, për këtë çështje ajo tha se asnjëherë nuk kanë marrë informacione si Komision.

Preng Gjetaj – Tha se kanë kërkuar vazhdimisht në bisedimet që zhvillohen me palën serbe lidhur me personat e zhdukur me ndërmjetësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të avancojnë në kuptim të mundësisë, trysnisë, detyrimit të palës serbe për të treguar vendndodhjen e varrezave masive, sepse dyshimet vazhdimisht janë që në hapësirën e Serbisë gjenden varreza masive, mirëpo ai e ritheksoi nevojën që të avancohet çështja e personave të pagjetur në bisedimet e ndërsjella në mes palës kosovare dhe asaj serbe dhe të futet si pikë e veçantë në këto bisedime në mënyrë që të arrihet deri te rezultatet.

Kushtrim Gara – Duke u ndërlidhur tha se Komisioni Qeveritar për personat e zhdukur, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nuk janë të ndara njëra nga tjetra, mirëpo Komisioni vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit përkatësisht Qeverisë. Lidhur me bisedimet ai e sqaroi se nuk ka mbetur çështja pezull për shkak të mungesës së bisedimeve me palën serbe, këto bisedime vazhdojnë që nga viti 2004, mirëpo rezultatet kanë munguar dhe për këtë kanë shfaqur pakënaqësinë Komisioni, si dhe familjarët e personave të zhdukur. Ai tha se qysh në rrethin e 4 të bisedimeve kur janë udhëhequr nga znj. Edita Tahiri Qeveria ka insistuar që të debatohet lidhur me fatin e personave të zhdukur. Kjo çështje është ngritur edhe në bisedimet në nivel kryeministrash, por tani janë duke analizuar mundësinë e angazhimit më të madh të Bashkimit Evropian në këtë drejtim. Lidhur me pyetësorin ai tha se e kanë dhënë një përgjigje përgjithësuese jo pyetje për pyetje, por janë të gatshëm për bashkëpunim në këtë drejtim, sepse ka rëndësi shumë të madhe monitorimi i këtij ligji në mënyrë që të vërehen të metat dhe pengesat e zbatimit të këtij ligji.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me pyetësorin e theksoi se edhe përkundër faktit se Komisioni Qeveritar deklaroi se janë përgjigjur në njëfarë mënyre në pyetësor Komisioni nuk është në dijeni se një gjë e tillë ka ndodhur.

Albana Gashi – E theksoi se ka arritur një përgjigje e cila ka theksuar se pyetjet janë të paqarta, kanë konotacion politik, si dhe keni propozuar Komisionit që ta bëjnë riformulimin e pyetësorit. Ajo ju sugjeroj të ftuarve që mos ta përsërisin këtë veprim në të ardhmen, sepse veprime të tilla nënkuptojnë ndërhyrje direkte në punët e legjislacionit.

Sa i përket pyetjeve me konotacion politik ajo tha se edhe vetë ligji është politik dhe një gjë e tillë sipas saj nuk është arsye që mos të japin përgjigje në pyetësor. Në vazhdim ajo tha se te neni 9, paragrafi 5 dhe 6 theksohet se Zyra e Kryeministrit i siguron Komisionit mbështetjen administrative dhe financiare që d.m.th. se Zyra e Kryeministrit i siguron mjete Komisionit. Ajo tha se edhe në takimet e tjera që kanë pasur me këtë Komision, ku i ftuar ka qenë edhe z. Gërxhaliu është thënë se në mungesë të stafit punët kanë shkuar ngadalë. Ajo e theksoi se pyetjet janë të bazuara në ligj, si dhe në atë që kanë thënë ata gjatë takimeve të kaluara që kanë pasur Komisioni për të Drejtat e Njeriut me Komisionin Qeveritar, si dhe institucionet e tjera të kësaj lëmie. Ajo e sqaroi se pyetësi u është drejtuar komplet Komisionit Qeveritar, e jo vetëm kryesuesit të këtij Komisioni, sepse në këtë Komision janë të përfshira disa ministri, si dhe departamente. Sa i përket paqartësisë së pyetjeve ajo tha se nuk ka paqartësi të pyetjeve pasi që ai tani më veç u përgjigj në ato pyetje për të cilat ka konsideruar se janë të paqarta. Në fund ajo e ritheksoi se Komisioni parlamentar nuk mund të përpilojë pyetësor, se si ju konvenon institucioneve të tjera, por vetëm në mënyrën se si vetë Komisioni akordohet.

Preng Gjetaj - E ritheksoi se nuk refuzojnë të përgjigjen në pyetësor, mirëpo disa pyetje kanë qenë të formuluar në atë mënyrë që më mirë kishte qenë t'i adresohen shoqatave të familjarëve të personave të pagjetur. Ai tha se edhe në të kaluarën kanë pasur bashkëpunim me Komisionin parlamentar duke e theksuar se çdo herë është njoftuar dhe është ftuar Komisioni parlamentar kur ka pasur takime Komisioni Qeveritar.

Biserka Kostiq – Konstatoi se nuk mund të lihen anash raportet e organizatave ndërkombëtare që japin të dhëna lidhur me transplantin e organeve. Ajo tha se nuk shihet asgjë të keqe nga pyetësi në të cilin kërkohen informacione se cilat janë mbështetjet që bëhen nga Qeveria duke konsideruar se nuk ka konotacion politik dhe se qëllimi është monitorimi i zbatimit të ligjit, sepse ka probleme në zbatim të ligjit. Ajo theksoi se Kosova nuk ka probleme me nxjerrjen e ligjeve, mirëpo ka probleme me zbatimin e ligjit dhe nuk ka arsye të mendohet se kjo pyetje është e pavend. Ajo po ashtu tha se në bazë të të dhënave të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar kanë filluar ta kompletojnë regjistrin për personat e zhdukur dhe ajo pyeti se a ka persona të zhdukur serbë në ato lista ose a ka pasur përfaqësues të familjeve të të zhdukurve gjatë hartimit të atij regjistri. Ajo pyeti se aktivitetet që kanë pasur në Mitrovicë dhe Skenderaj e Klinë, a kanë qenë në kuadër të zbatimit të ligjit dhe, a kanë pasur ndonjë familjar të personave serbë të zhdukur në ato aktivitete. Dhe në fund ajo pyeti se a i shfrytëzojnë beneficionet sipas ligjit familjarët e personave të zhdukur serbë.

Preng Gjetaj – Ishte i mendimit se asnjë ligj nuk zbatohet në mënyrë më transparente se sa Ligji për personat e zhdukur, duke e përmendur se gjithmonë aktivitetet bëhen në bashkëpunim me familjet. Ai e theksoi se vërejtjen qëndrojnë në faktin se është e nevojshme që të ndryshohet dhe plotësohet ligji. Po ashtu ai tha se edhe në teren Komisioni vazhdimisht është prezent kur bëhen gërmime lidhur me gjetjen e mbetjeve mortore të personave të zhdukur.

Biserka Kostiq – Po ashtu kërkoi informacion se a po e përshkruajnë regjistrin ndërkombëtar, apo janë në formulim të regjistrin të ri.

Prenk Gjetaj – Tha se janë duke e begatur me të dhëna të reja të cilat po i inkorporojnë në regjistër.

Biserka Kostiq – Pyeti se a janë të inkuadruar edhe serbët gjatë përpilimit të regjistrit të ri nga zyrtarët kosovarë.

Prenk Gjetaj – Tha se janë duke kërkuar ndihmë edhe prej serbëve të Kosovës dhe edhe prej përfaqësuesve të Komisionit të Beogradit, janë duke kërkuar të dhëna për t'i inkorporuar në regjistër. Ai po ashtu tha se që nga nxjerrja e ligjit është i rezervuar vendi për përfaqësuesit e komunitetit serb në Komision.

4. Informata e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale për gjendjen në Institutin Special në Shtime dhe informata e Ministrit të Shëndetësisë për gjendjen në Qendrën e Shëndetit Mendor në Shtime

Kryetarja – I njoftoi të pranishmit se Komisioni ka pasur një vizitë në qendrën e shëndetit mendor në Shtime dhe gjendja e cila ka mbretëruar në atë qendër nuk ka qenë e lakmueshme për anëtarët e Komisionit.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur tha se para disa muajve anëtarët e Komisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut kanë zhvilluar një vizitë në Institutin e Shëndetit Mendor në Shtime. Ajo theksoi se aty kanë mësuar se kjo qendër ndahet në dy pjesë, njëra pjesë është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe pjesë tjetër në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Lidhur me gjendjen në këtë qendër ajo tha se gjendja ka qenë shokuese, mirëpo fakti më shqetësues ka qenë mungesa të elementeve esenciale si p.sh. mungesa e psikologëve, neurologëve, psikiatërve, pastaj çështje tjetër shqetësuese ishte edhe fakti se për intervenime mjekësore të këtyre personave ata dërgohen në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Mirëpo pas kryerjes së intervenimit Qendra e Shëndetit Mendor është e obliguar që ta sigurojë personalen që të kujdesët për personin e kësaj qendre edhe pse ai gjendet në QKUK. Ajo tha se kjo ka paraqitur shumë herë probleme, sepse kjo qendër ka mungesë të stafit dhe një gjë e tillë është realizuar më vështirësi. Probleme të tjera që ajo përmendi ishin mungesa në veshmbathje pastaj në ushqime në medikamente dhe shumë gjëra të tjera.

Nenad Rashiq – Tha se nuk ka marrë asnjë raport në të cilin janë përfshirë vërejtjet e Komisionit lidhur me institucionin në Shtime dhe tha se këto informacione që po theksohen në Komision tani po i dëgjon. Ai tha se po ta kishin një raport të shkruar ata do t'i sjellin përgjigjet në ditën e mbledhjes në mënyrë me të qartë. Ai tha se do të japë disa informacione, por do të precizohet vetëm në gjërat që i takojnë Ministrisë së Punës dhe të mos përzihen me kompetencat që i ka Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket Kompetencave të Ministrisë së Punës ai tha se po i realizojnë ato sipas normave dhe standardeve të parapara. Ai tha se ndoshta nuk janë në nivel të kënaqshëm, por nuk mund të thuhet se janë keq dhe gjendja nuk është shokuese dhe jashtë standardeve ose normave të përcaktuara. Ai tha se renovimin e qendrës e bëjnë çdo vit dhe bëjnë riparime të

stabilimenteve varësisht nga nevojat që paraqiten. Gjatë tri viteve të fundit kanë marrë masa të vazhdueshme për përmirësimin e gjendjes në Shtime.

Muhamet Gjocaj – Duke u ndërlidhur tha se situata në këtë qendër që nga viti 2006 është më mirë se si ka qenë në të kaluarën. Këtë ai e tha duke u bazuar në faktin se në këtë qendër kanë qenë të bëra bashkë rastet me ngecje mendore të lindura, rastet psikiatrike që shfaqen më vonë. Kjo është bërë me insistimin e tyre si ministri me qëllim që t'i ndajnë përgjegjësitë dhe kjo është arritur në vitin 2006 kur është bërë ndarja fizike dhe profesionale e këtyre dy kategorive të njerëzve. Që nga viti 2006 nën kompetencën e tyre është vetëm pjesa e Institutit Special në Shtime. Ai i informoi anëtarët e Komisionit se qëllimi i tyre gjithmonë ka qenë angazhimi për përmirësimin e gjendjes së këtyre personave dhe krijimi i mundësisë që ata të shërohen dhe të dalin jashtë kësaj qendre. Ai po ashtu tha se janë ndërtuar 8 objekte më të vogla në të cilat janë vendosur personat nga kjo qendër. Në Institutin Special në Shtime janë akoma 62 klientë të cilët e kanë gjendjen më të rëndë në bazë të diagnozave të caktuara nga ekspertët dhe pavarësisht këtij fakti nga deklaratimet e ekspertëve nuk është asnjë diagnozë e cila nuk mund të shërohet. Ai e theksoi se kanë probleme financiare, sepse ju nevojitet një shumë e konsiderueshme e të hollave për ndërtimin e 6 shtëpive të tjera në mënyrë që të krijohen kushtet për nxjerrjen e këtyre personave nga kjo qendër. Probleme tjetra që ai i përmendi ishin vështirësitë e angazhimit të stafit të ri, sepse Ministria e Financave nuk u ka lejuar angazhim të stafit të ri, si pasojë e stërngarkimi të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me staf dhe kjo gjendje ka vazhduar në tri vitet e fundit edhe përkundër planifikimeve, sepse stafi aktual nuk mjafton për kryerjen e obligimeve. Duka pasur para sysh sjelljet e këtyre personave të cilat nuk janë të kontrolluara ai tha se kërkesat e menaxhmentit nuk mund të jena të harmonizuara me procedurat e prokurimit. Ai e përmendi se në kohën e fundit janë bërë investime mjaft të mira duke e theksuar se është duke u rinovuar reparti (A). Ai po ashtu i informoi se është rregulluar ambienti i jashtëm i kësaj qendre ku u mundësohet klientëve të qëndrojnë më mirë. Një javë më herët ai tha se Instituti është furnizuar me 60 dyshekë të kualitetit të lartë dhe janë duke u rregulluar shtigjet. Duke pasur para sysh standardet ai tha se ka mungesa stafi, sepse në bazë të standardeve për një klient është e nevojshme që të ketë 1.5 anëtar të stafit dhe kur është në pyetje pushimi i lindjes te stafi atëherë ka probleme të mëdha në kompensimin e stafit, sepse problemet që i shkakton Ministria e Financave shkaktojnë mungesë të stafit në këtë Institucion. Ai tha se në këtë Institucion është mjeku, laborator, barnatoren. Ai e theksoi se deri vonë kanë pasur marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë, e cila i ka furnizuar me listën bazike të barërave, mirëpo tani nuk sjellin më barëra nga kjo ministri, sepse mungon lista bazike e këtyre medikamenteve. Lidhur me kontrollimin nga psikiatri ai tha se klientët kontrollohen dy herë në javë nga psikiatri. Në përfundim ai theksoi se nuk është gjendja shokuese, nuk ka mungesë të psikologut dhe lidhur me ndërhyrjet të cilat bëhen në QKUK është e natyrshme, sepse asnjë shtëpi nuk mund ta ketë klinikën e vet, mirëpo konstatoi se ka mungesa në staf.

Albana Gashi – Ishte e mendimin se kjo kategori meriton kujdes të veçantë pasi që është kategori e veçantë shoqërore. Ajo kërkoi informacion se si sigurohen barërat esenciale pasi që nga deklaratimet e tyre u konstatua se kjo listë mungon.

Muhamet Gjocaj - Tha se të gjitha barërat blihen. Më parë një pjesë e tyre është sjellë falas nga Ministria e Shëndetësisë, mirëpo tani të gjitha blihen nga Ministria e Punës he Mirëqenies Sociale.

Albana Gashi – Tha se të dhënat që janë paraqitur nga anëtarët e Komisionit janë konstatuar nga vizita që ky Komision i ka bërë kësaj qendre disa muaj më parë. Vërejtje tjetër që ajo paraqiti ishte çështja e kujdestarëve të natës. Ajo tha se kujdestaria gjatë natës dhe rrezikshmëria në punë nuk paguhet dhe kjo është e nevojshme të bëhet, sepse ajo i informoi se ka disa raste që anëtarët e stafit janë lënduar nga klientët në vendin e punës dhe ata janë detyruar që të gjitha shërbimet mjekësore t'i paguajnë me paratë e tyre.

Muhamet Gjocaj – I informoi se qendra punon në 4 ndërrime dhe që nga viti i kaluar është bërë një rritje e dukshme e pagave të tyre për shkak të rrezikshmërisë. Lidhur me rrezikshmërinë në punë, ai tha se asnjë nuk është i siguar nga rrezikshmëria në punë dhe nuk mund të bëhen përjashtime vetëm për punëtorët e Shtimes lidhur me sigurimin shëndetësor.

Albana Gashi – Bëri pyetje për çështjen e teknikëve që duhet ta përcjellin klientin për në QKUK se a kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë që në raste të tilla ata ta bëjnë sigurimin e infermierit pas intervenimeve kirurgjike, sepse në bazë të informacioneve ajo tha se pas intervenimit kirurgjik në QKUK për klientin duhet të kujdeset stafi i qendrës së Shtimes dhe jo nga QKUK – ja.

Muhamet Gjocaj - Tha se këtë përgjigje mund ta marrin nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse për aq kohë sa qëndron pacienti atje duhet të jetë nën përgjegjësinë e tyre.

Kimete Bytyqi – Pyeti ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale fakti që në qendër nuk ka psikolog a mendon se është jashtë standardeve. Ajo ishte e mendimit se shumë gjëra në këtë qendër janë jashtë standardeve duke u bazuar në kërkesat që ata i bëjnë pikërisht në këtë takim. Ajo po ashtu bëri pyetje se a është e mjaftueshme që klientët të kontrollohen vetëm dy herë në javë nga psikologu. Ajo tha se në qendra të tilla psikologu është i detyruar të qëndrojë çdo moment prezent.

Nenad Rashiq – Tha se pasi është politikan e ka sjellë ekspertin për të dhënë përgjigje profesionale në këto pyetje për të cilat jemi ftuar në takim.

Kryetarja – Lidhur me bashkëpunimin mes Komisionit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale tha se vetë prezenca e ministrit tregon gatishmërinë e tij që çdo gjë që është e paqartë të sqarohet dhe përpjekja e Ministrit për të sjellë konkluzione tregon interesimin e tij për ndryshime në aspekt pozitiv.

Muhamet Gjocaj – Lidhur me psikologun e ritheksoi se psikologu ekziston dhe është me renome në vend i cili dy herë në javë mendon se është e mjaftueshme, sepse ky përcaktim ka ardhur nga vetë psikologu, e jo nga Institucioni.

Kimete Bytyçi – E pyeti ministrin se a ka qenë ndonjëherë në vizitë në këtë qendër.

Nenad Rashiq – Tha se ka qenë tri herë vizitë në këtë qendër. Po ashtu tha se duke pasur para sysh gjendjen e atyre personave është dashur më shumë të vizitohen, por nuk ka pasur mundësi që të vizitojë më shumë.

Kryetarja – Po ashtu i informoi të pranishmit se aty është përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, sepse një pjesë e kësaj qendre është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Albana Gashi – Përmendi kërkesat e qendrës që është nën menaxhimin e Ministrisë së Shëndetësisë të cilat janë të ngjashme me kërkesat e pjesës tjetër të qendrës e cila është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ajo theksoi se që nga viti 2006 në këtë qendër nuk është punësuar asnjë punëtor, ndërsa numri i klientëve është në rritje. Shqetësim tjetër që ajo paraqiti ishte mungesa e mjekut të përgjithshëm kur dihet se në raste të tilla prezenca e vazhdueshme e mjekut të përgjithshëm është shumë e nevojshme, ka mungesë të psikologut, neurologut, numri i punëtorëve social është i pamjaftueshëm, po ashtu numri i shoferëve është i pamjaftueshëm. Vërejtje tjetër që ajo paraqiti ishte edhe çështja e kuzhinierit. Në këtë qendër kuzhinieri është i detyruar të përgatitë në dy ndërrime për të gjithë rezidentët duke i përfshirë edhe stafin. Problem tjetër që është konstatuar gjatë vizitës është borxhi i cili është i trashëguar vazhdimisht sepse nevojat e qendrës janë të asaj natyre dhe në këtë mënyrë borxhi bartet. Ajo i informoi edhe për një fakt i cili tregon se nga viti 2007 nga Qeveria nuk është ndarë asnjë cent shtesë përveç asaj që është e planifikuar edhe pse janë të informuar për mungesat e kësaj qendre. Duke pasur para sysh faktin se borxhi është bartur në vazhdimësi tregon se kjo qendër ka mungesa financiare, sepse është e detyruar që t'i paguaj borxhet që janë bartur nga e kaluara. Ajo e përsëriti se këto janë të dhënat që janë marrë nga qendra gjatë vizitës së bërë në muajin korrik të këtij viti. Si problem mjaft serioz që ajo e theksoi ishte dalja në zgjedhje e rezidentëve në të dy qendrat edhe pse rezidentëve u është hequr e zotësia e veprimtimit nga gjykata këta megjithatë kanë votuar, sepse u është mundësuar votimi brenda qendrës. Ajo e theksoi se lidhur me këtë ata e kanë marrë pohimin nga personeli punonjës në qendër.

Gani Halilaj – Theksoi se shëndeti mendor është në nivelin më të lartë në rajon sa i përket funksionimit dhe organizimit. Mirëpo ai theksoi se ka nevoja të angazhimit të stafit profesional dhe çështja e buxhetit duhet të përmirësohet, sepse nevojitet përkujdesje e madhe ndaj kësaj kategorie të njerëzve. Ai tha se kanë projekte dhe plane të ndryshme, mirëpo realizimin e tyre po e dikton çështja e buxhetit. Ai e theksoi se ka dhënë një përgjigje lidhur me rekomandimet që ka bërë KMDLNJ nga vizita në këtë qendër të cilën shkresë e ka përcjellë edhe te anëtarët e Komisionit. Lidhur me mungesën e psikiatrit ai tha se rolin e psikiatrit duhet ta ketë drejtori, sepse ai duhet të jetë edhe psikiatër dhe kjo çështje pritet që të zgjidhet së shpejti. Sa i përket mungesës së mjekut të përgjithshëm ai tha se nuk është e paraparë në strategji që të ketë mjek të përgjithshëm. Lidhur me udhëzimin e klientëve kur kanë sëmundje të tjera ai tha se këtë e bënë psikiatri. Lidhur me punëtorët social ai tha se e kanë të paraparë këtë çështje dhe kjo pritet të bëhet vitin e

ardhshëm. Rreth pranimi të rezidentëve ai tha se e kanë Komisionin në kuadër të të cilit është punëtori i mirëqenies sociale dhe në bazë të vlerësimit të këtij Komisioni bëhet pranimi i këtyre rezidentëve.

Albana Gashi – Pyeti se si është e mundur të lejohen këta persona të votojnë kur dihet se u është marrë zotësia e veprimit, po ashtu pyeti se a kanë kërkuar nga Ministria e Financave që ata kanë nevojë për buxhet shtesë, sepse pa buxhet nuk mund të plotësohen nevojat e domosdoshme për këtë qendër.

Gani Halilaj – Sa i përket planit buxhetor ai tha se që nga viti 2010 është pothuajse i njëjtë dhe shuma nuk ndryshon, kurse buxheti për mallra dhe shërbime ai ka pasur rënie në vitet e fundit. Ai e theksoi se përkundër kërkesave që kanë bërë nuk kanë ngritje të buxhetit, por edhe kërkesat që i kanë bërë për infermier as ato nuk janë realizuar deri më tani. Sa i përket çështjes së votimeve ai tha se në këtë qendër punon që nga viti i kaluar dhe nuk është në dijeni se a kanë votuar apo jo, mirëpo premtoi se një gjë e tillë nuk do të ndodhë në votimet që do të mbahen në këtë vit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Takimi ka filluar nga pika 3 e rendit të ditës si dhe pika në të cilën bëhet shqyrtimi i Planit të Punës u shty për takimet e radhës. Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 korrik 2013

Procesverbali u miratua me vërejtjet e Biserka Kostiq.

.

6 Shqyrtimi i peticioneve.

Kurtan Kajtazi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se janë tri peticione. Njëri është një kërkesë që i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nga një lagje e qytetit të Vushtrrisë, të cilët kërkojnë mos dhënien e lejes për ndërtimin e xhamisë. Lidhur me këtë çështje ai tha se është bërë një kërkesë nga Bashkësia Islame për ndërtimin e një xhamie në këtë zonë dhe për këtë arsye qytetarët janë drejtuar me këtë kërkesë në të cilën kërkojnë që mos t'u jepet leja për ndërtimin e kësaj xhamie. Ai tha se në këtë zonë nuk ka plan urban dhe për ndërtime është e nevojshme që të kërkohet mendimi i banorëve të kësaj zone. Ai ishte e mendimit që të kërkohej dokumente shtesë, si dhe të kërkohej një mendim nga Drejtorati për Urbanizëm i Vushtrrisë lidhur me këtë çështje.

Pas një debati Komisioni vendosi të nxjerrë këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të drejtat e Njeriut vendosi që të kërkojë nga Drejtorati për Urbanizëm në Komunën e Vushtrrisë që të japë mendim lidhur me këtë çështje në mënyrë që ta ketë të

qartë situatën për të cilën banorët kanë kërkuar mos dhënien e lejes së ndërtimit të xhamisë.

Kurtan Kajtazi – Duke shqyrtuar kërkesën e dytë tha se është një kërkesë nga ndërmarrja bujqësorë “ Suhareka “ e cila nuk është petition por më shumë është një komentim i njerëzve të kësaj ndërmarrje e cila ka përmbajtje fyese ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës. Ai ishte e mendimit që ky mendim nuk i plotëson kriteret për shqyrtim dhe si i tillë mos të shqyrtohet fare nga Komisioni pasi që lënda është në dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Komisioni nuk e ka asnjë kompetencë për të shqyrtuar këtë lëndë.

Kimete Bytyçi – Theksoi se disa punëtorëve në Suharekë nuk ju është dhënë 20 % dhe ajo ishte e mendimit se është mirë që të ftohen përfaqësuesit e AKP- së.

Albana Gashi – Lidhur me këtë lëndë tha se është bërë ankesë në AKP, në gjykata dhe nuk ka marrë përgjigje dhe tani u kanë drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Ai ishte e pajtimit që kur lënda është në gjykatë Komisioni nuk ka të drejtë që të përziehet në këto çështje, mirëpo çështje shqetësuese ajo tha se është zvarritja e lëndës. Ajo i informoi anëtarët se kjo ndërmarrje është privatizuar me Spin Off special dhe i ka pasur disa kriteret për t’i plotësuar. Ajo tha se jo vetëm që nuk janë plotësuar kushtet, por është shkatërruar veprimtaria, podrumi është shkatërruar dhe janë shitur elementet e brendshme që kanë kushtuar miliona dhe në atë pjesë është planifikuar që të ndërtohen ndërtesa, vreshtaria është shkatërruar me qindra hektarë, kanë mbetur vetëm 100 hektarë rrush tryeze, të tjerat janë shkatërruar. Ajo tha se nuk është vazhduar veprimtaria pas privatizimit të ndërmarrjes, por është shkatërruar krejtësisht dhe për këtë AKP-ja nuk po ndërmerr asgjë, po ashtu edhe gjykatat dhe për këtë ju janë drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur tha se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është themeluar nga Kuvendi me Ligj të Veçantë. Ajo ishte e mendimit që Kuvendi mund të marrë masa ndaj kësaj dhome për shkak të zvarritjes së lëndëve të shumta që janë në kompetencë të saj.

Kryetarja – Tha se kjo nuk i plotëson kushtet për shqyrtim, sepse nuk është petition apo kërkesë. Lidhur me shqetësimet që i ngritën anëtarët e Komisionit lidhur me këto çështje ajo tha se në takimin e radhës mund të vendosin që të kërkohet debat parlamentar për punën e Dhomës së Veçantë dhe privatizimin në përgjithësi, mirëpo edhe për këtë ajo tha se fillimisht duhet të analizojnë se a kanë drejtë të kërkojnë një gjë të tillë, mirëpo për këtë duhet të vendosin në takimin e radhës.

Pas një debati të gjerë lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione pasi shqyrtoi lëndën e paraqitur nga punëtorët e ndërmarrjes Suhareka konstatoi se kjo lëndë

nuk është petition dhe as kërkesë dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe nuk shqyrtohet.

Kurtan Kajtazi – Lidhur me ankesën e z. Arsim Agani ish- drejtor i Departamentit të Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit. Lënda ka të bëjë me ankesën kundër Institucioni të Avokatit të Popullit për mosekzekutimin e Vendimit të formës së Prerë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë. Ai tha se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka marrë vendim për kthimin e z. Arsim Agani në punë, por Institucioni i Avokatit të Popullit nuk e ka zbatuar këtë vendim.

Kryetarja – Theksoi se vetë fakti i ekzistimit të vendimit të formës së prerë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës tregon se Institucioni i Avokatit të Popullit është i detyruar ta kthejë në punë z. Arsim Agani.

Pas një debati lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i rekomandon Institucionit të Avokatit të Popullit që ta zbatojë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe ta kthejë në punë z. Arsim Agani.

7 Të ndryshme

Kryetarja – Lidhur me raportin me rekomandimet për të drejtat e fëmijëve kërkoi pëlqimin e anëtarëve të Komisionit se si t'i drejtohen Kuvendit. Ajo ishte e mendimit se Raporti të paraqitet në Kuvend për shqyrtim dhe të miratohen rekomandimet e raportit në Seancë Plenare, sepse njoftimi nuk e ka peshën sikur shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve.

Kurtan Kajtazi – Tha se është më mirë që fillimisht të analizohet nga anëtarët e Komisionit dhe pastaj të vendoset se në cilën mënyrë t'i drejtohen Kuvendit.

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e Komisionit.

Kryetarja – Ishte e mendimit të formohet një grup punues për monitorimit e Çerdheve të cilat janë dykatëshe dhe të cilat posedojnë licencë pune. Ajo tha se duhet të vizitohet fillimisht institucioni që u ka dhënë leje, e pastaj duhet të vizitohen çerdhet dykatëshe.

Pas një debati të gjerë lidhur me këtë çështje Komisioni mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi Punues për monitorimin e çerdheve dykatëshe, si dhe institucioneve që u kanë dhënë licencën e punës.

2. Grupi Punues përbëhet nga:

- Suzana Novoberdaliu – kryesuese,
- Rita Hajzeraj – Beqaj, anëtare,
- Kurtan Kajtazi, anëtar,
- Kymete Bajraktari, anëtare,
- Albana Gashi, anëtare,
- Kimete Bytyqi, anëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali